LAJME / KRONIKA E ZEZË

Dy persona për një borxh kërcënojnë me armë tre të tjerë në Viti



Foto: Ilustrim

13 orë

Dy persona janë arrestuar pasi kishin shkuar te shtëpia e një personi tjetër për t'ia kërkuar një borxh prej 300 euro, dhe më pas njëri prej tyre i kishte kërcënuar me armë zjarri edhe anëtarët e tjerë të asaj familje.

Sipas raportit të Policisë së Kosovës, ngjarja ka ndodhur të mërkurën rreth orës 21:00, në Viti.


Siç thuhet në raport, të dyshuarit pas intervistimit, me vendim të prokurorit janë dërguar në mbajtje për 48 orë.

"Janë arrestuar dy të dyshuar meshkuj kosovarë të cilët kishin shkuar te shtëpia e viktimës mashkull kosovar për t'ia kërkuar një borxh prej 300 euro. Njëri prej të dyshuarve pasi i kishin marrë paratë nga vetura me të cilën kishin qenë dyshohet se kishte marr një armë zjarri ku kishte kanosur viktimën, bashkëshorten dhe djalin e tij, më pas ishin futur në veturë dhe larguar nga ai lokacion. Të dyshuarit pas intervistimit, me vendim të prokurorit janë dërguar në mbajtje për 48 orë", thuhet në raport. **/Telegrafi/**

Kërcënim me armë | Policia e Kosovës | Viti

Lajme | Telegrafi

Më të lexuarat në Lajme


Një tjetër vrasje në Vlorë



Hoxhaj: Urime Jugosllavia e re Albin!


Analistët komentojnë ftesën e Kurtit për opozitën lidhur me dialogun dhe refuzimin e Hoxhajt


Haradinaj: Deklaratat e Kurtit për kriminelët e luftës, akt tradhtie

CORONAVIRUS më shumë


Krejt çfarë dihet rreth "pasaportës për COVID-19 të BE-së"


Vazhdojnë patrullimet e policisë

Bie numri i pacientëve, mbyllet klinika COVID-19 në Mjekësinë Sportive në QKUK

Një viktimë dhe 35 raste të reja me Covid-19 në Shqipëri

PETROL
Del në shitje magazina e produkteve të naftës me vendodhje në Kosovë
Sponzorizuar
Lexo më shumë


Programi Dimagra, si t'i humbisni kilogramët e tepërt për 10 ditë
Sponzorizuar
Lexo më shumë

TELEGRAFI sh.p.k.
Rr. Rexhep Mala, Aktash, Nr.34, Prishtinë, Kosovë
info@telegrafi.com 038 224 093 - +383 48 222 355

Ky portal mirëmbahet nga kompania "Telegrafi". Materialet dhe informacionet në këtë portal nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër për qëllime përfitimi, pa miratimin e drejtuesve të "Telegrafit". Për ta shfrytëzuar materialin e këtij portali obligoheni t'i pranoni Kushtet e përdorimit.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara © 2006-2021 Portali Telegrafi